

SHTOJCË NR. 1, DATË 10.03.2020

“Për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit “Procedure e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik kur të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 48 muaj, me objekt “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinçi” Elbasan dhe qendrat në varësi të tij”, me fond limit 268,475,020 (dyqind e gjashtëdhjetë e tetë milion e katërqind e shtatëdhjetë pesë mijë e njëzetë) lekë pa TVSH dhe REF-50034-02-11-2020.

Në zbatim të nenit 42, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, (i ndryshuar), dhe nenit 62 të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, bëhen ndryshimet si vijon në dokumentat e tenderit:

Tek Shtojca 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”:

**Tek pika 3.2, Kapaciteti ekonomik dhe financiar:
ISHTE:**

1. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit 2016, 2017, 2018, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.
2. Kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: 2016, 2017, 2018 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore.

BËHET:

1. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit 2017, 2018, 2019, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.
2. Kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: 2017, 2018, 2019 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore.

Tek pika 3.3, Kapaciteti teknik, nënpika 4:

ISHTE:

- 4) Operatori ekonomik duhet të ketë jo më pak se 32 (tridhjetë e dy) persona të punësuar në sektorin e shërbimit të ushqimit, të siguruar për periudhën Janar 2020 - Mars 2020. Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë:
 - Një vërtetim nga administrata tatimore për numrin mesatar të punonjësve për periudhën Janar 2020 - Mars 2020.
 - Listepagesat (E-Sig 025) të konfirmuara nga Administrata Tatimore për periudhën Janar 2020 - Mars 2020.

BËHET:

- 4) Operatori ekonomik duhet të ketë jo më pak se 32 (tridhjetë e dy) persona të punësuar në sektorin e shërbimit të ushqimit, të siguruar për periudhën Dhjetor 2019 - Shkurt 2020. Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë:
 - Një vërtetim nga administrata tatimore për numrin mesatar të punonjësve për periudhën Dhjetor 2019 - Shkurt 2020.
 - Listepagesat (E-Sig 025) të konfirmuara nga Administrata Tatimore për periudhën Dhjetor 2019 - Shkurt 2020.

Afati kohor për dorëzimin dhe hapjen e ofertave, shtyhet për në datën 10.04.2020 ora 11:00.

Hapja e ofertave do të bëhet në faqen zyrtare të internetit www.app.gov.al, si dhe pranë Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara, Ministria e Brendshme, Sheshi Skënderbej, nr. 3, Tiranë.